REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.1325 Prot. Maliq, më 02.03.2026

VENDIM
Nr.34, datë 27.02.2026

PËR
"MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIM DHE NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIN TË DISA PRONAVE NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA MALIQ"

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.2, shkronja "a" dhe "c", nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar, nenit 13 dhe 15, shkronja "c", ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 "*Për pronat e paluajtshme të shtetit*", i ndryshuar, nenit 3, shkronja "a", dhe nenit 5 të ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 "*Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore*", i ndryshuar, nenit 40 të ligjit nr. 20/2020 "*Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë*", Këshilli Bashkiak Maliq,

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës për transferim të pronave në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes të Bashkisë Maliq, të cilat do të përdoren për projekte zhvillimore e social-kulturore, të cilat janë:

   - Prona me nr. Rendor 558, me emërtim "Ish Grup depo Municioni", me vendndodhje Lozhan, me nr. Pasurie 52/9, referuar dokumentacionit tekniko ligjor bashkëlidhur.
   - Prona me nr. Rendor 559, me emërtim "Ish rezervat e DK", me vendndodhje Lozhan, me nr. Pasurie 51/9, referuar dokumentacionit tekniko ligjor bashkëlidhur.
   - Prona me nr. Rendor 560, me emërtim "Ish depo municioni", me vendndodhje Plovisht, me nr. Pasurie 47/1, referuar dokumentacionit tekniko ligjor bashkëlidhur.
   - Prona me nr. Rendor 1258, me emërtim "Ish Rep.Usht nr.5466", me vendndodhje Sovjan, me nr. Pasurie 684, referuar dokumentacionit tekniko ligjor bashkëlidhur.

2. Ky vendim hyn në fuqi sipas percaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë.

Miratuar me 20 vota
Vota Pro 20
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 02.03.2026

NË MUNGESË
DHE ME POROSI
ZV/KRYETARI I KËSHILLIT
Enida AVDOLLI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ